



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Prenjari - Prenjari 1880/2000		17-09-2020	
Nr. i organit Org.broj	Nr. i dërgimit Dërg.broj	Lloji i aktit Lloji	Vlera Vrednos
01-060/01-893			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 i Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, ne Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -VI- të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **23.09.2020 (e Merkur)**, duke filluar në ora 10,00.

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave tek objektin i ri i Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2021-2023.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2021.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e normave tatimore në pronën e paluajtshme për vitin 2021
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët në komunën e Vitisë
6. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit nr.01-110/05-764 për plotësim ndryshim e vendimit Nr.01-110/05-370, të datës. 08.05.2020 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e ambulancës shëndetësore në Tërpezë
7. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit Nr.01-110/05-546 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale NPSH Arena Sport në Kabash.
8. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për krijimin e qasjes së parcelës Nr. 3760-0, në rrugën publike me nr.2592-11, përmes parcelës me nr.2582-6 dhe nr.2582-8.
9. Propozim vendim për miratimin planit të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2021.
10. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për lirimin e znj. Hazire Gjela anëtare e Komiteti për Komunitete ne Komunën e Vitisë.

Me respekt!

Viti, më 17.09.2020

Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA E PESTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **23.07.2020 (e enjte)**, në zyrën e konferencave ne objektin e ri të komunës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Idajete Pira, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje media të shkruara dhe elektornike, si dhe ju të pranishëm dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e pestë të rregullt të KPF-së për këtë vit. Mes dy seancave kemi konfirmimin e disa nga aktet na i ka konfirmuar MAPL-ja dhe disa na i ka rikthyer, d.m.th. dy na i ka rikthye. Vendimin për ambulanten në fshatin Terpezë. ka kërkuar me harmonizuar në bazë të planit zhvillimor, me siguri ndonjë gabim nga propozuesi ka qenë. Dhe ndoshta është mirë me ju informuar, se isha pak ma herët pjesë e komitetit emergjent, me ju informuar shkurtimisht rreth situatës që e kemi në Komunën e Vitisë, sepse drejtoresha e Shëndetësisë na i sjelli një informatë. Testime deri tash në Komunën e Vitisë janë bërë 434 testime kanë qenë, raste pozitive i pasmi 158 raste, negative 276 raste, të shëruara 119 raste, aktive 31 raste, të spitalizuara 7 persona, të izoluar 54 dhe kemi 7 raste të vdekjes. Unë po e shfrytëzoj rastin të ju shprehi ngushëllime të gjithë familjareve të cilët kanë humbur anëtarët e familjes, njëherit pasi që i kemi doktorëshat këtu, po ju shprehi ngushëllime për humbjen e jetës së kolegut të tyre. Gjithashtu desha të ju informoj, se dje na ka ardhur raporti i auditorit të jashtëm, prapë ishim dal si komunë e pakualifikuar, diçka të veçante nuk kam me shtuar. Unë kisha hap debat para se me hy në rendin e ditës: a donë ta merr fjalën dikush? Nëse nuk ka, po them edhe njëherë, pasi që jemi në kohë pandemie, kisha kërkuar që të kemi kujdese në këtë aspekt. Pasi nuk ka për diskutim, për seancën e pestë të rregullt të KPF-së, kemi paraparë këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar- qershor 2020
3. Propozim vendim për shpalljen në diskutim publik propozim rregulloren për taksa , ngarkesa dhe gjoba për vitin 2021.
4. Propozim vendim për shpalljen në diskutim publik propozimin e rregullores për ndryshimin e rregullorës për Tatimin në Pronë të Komunës së Vitisë për vitin 2021.
5. Propozim vendim për formimin e komisionit vlersues dhe zbatimin e proceduarave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim
6. Propozim vendim paraparak për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik

7. Propozim vendim për shfuqyimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e ambulancës shëndetësore në fshatin Tërpezë të datës 07.05.2020, me nr.02-035/02-366.
8. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e vendimit nr.01-110/05-370 të datës. 08.05.2020 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e ambulancës shëndetësore në Tërpezë
9. Propozim vendim për caktimin e komisionit për intervistimin, vlersimin , poentimin e kandidateve të cilët kanë konkuruar në konkurset publike për pozitat Drejtor, zv. Drejtor të shkollave fillore- mesme dhe qerdhës së fëmijeve të komunës së Vitisë .
10. Propozim vendim për miratimin e rregullorës për menaxhimin e mbeturinave.
11. Propozim vendim për miratimin e draft planit komunal për menaxhimin e mbeturinave të komunës së Vitisë 2020-2025
12. Propozim vendim Plani Komunal i veprimit për Eficencë të Enërgjisë (PKVEE) 2019-2021
13. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2019-2020 nga DKA- Viti.
14. Raporti i prokurimit dhe kontratave të nënshkruara për gjashtë mujorin e vitit 2020.

Kemi një agjendë mjaftë të ngjeshur: A ka dikush sa i përket rendit të ditës ju lutëm?

z.Bekim Azizi: Unë kisha kërkuar që raporti i prokurimit nuk është, se këtu nuk ka asnjë kontratë, kisha kërkuar sot me hekë prej rendit të ditës, pasi që nuk është informata e plotë. E dyta, kisha kërkuar për kuvend të jetë në rend dite miratimi i një deklarate lidhur me aktakuzën që është bërë për krime të luftës.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Me lejen tuaj, ne kemi një propozim shtesë nga ekzekutivi, ku kemi informatën e kryetarit dhe e bashkëngjisim edhe propozimin tuaj.

z.Jakup Demiri: Kemi edhe një kërkesë nga Lëvizja Vetëvendosje. Një raport nga Drejtoria e Bujqësisë, sa i përket vërshimeve. Sa ka përfutur komuna e jonë, cilët janë përfutuesit dhe në bazë të cilave kritere janë zgjedhur përfutuesit.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Unë si informacion mundem me ta dhënë në kuvend, mundemi me sjell edhe informatën, ka qenë miks një komision, besoj se vetëm Skifteraj është përfshi. Sa a shuma nuk e di, është me rendësi se edhe takimi para disa dite i kryetarit me ministrin, ka qenë për këtë çështje. Mund të sjellën edhe personat që kanë konstatuar nga ana e komisionit që janë dëmtuar.

Kryesuesi z. Naim Pira: Unë po e qes në votim me propozim të Bekimit, që të hekët pika: informatë nga Zyra e Prokurimit; meqenëse na ka ardhur përgjegjësi i Zyrës së Prokurimit, unë ja kisha dhanë fjalën. Atëherë po e qes në votim rendin e ditës duke tërhek piken. Kush është që të miratohet rendi i ditës? Konstatoj se me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa

A ka dikush rreth pikës së parë? Nëse nuk ka, po e qesë në votim që të miratohet pika e parë. Konstatoj se me vota unanime u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Si pike të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Pasqyrat financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar- qershor 2020

Ja kaloj fjalën drejtorit për këtë pikë.

z.Ibrahim Rama: Si zakonisht pasqyrat financiare janë obligim ligjor, që për çdo tre muaj të paraqiten para KPF-së dhe Kuvendit. Do të mundona sa për shkarim në pika të shkurtra. Mjete të alukuara për gjashtë muaj është 5 milion e 588 mijë euro. Prej kësaj i kemi shpenzuar 4 879 440 euro, shprehur në përqindje buxheti është shpenzuar 87,32%. Për kategori ekonomike i keni të pasqyruara edhe në dokumentin që e keni para jush. Për ma shumë nuk dua të ju marr kohë, për pyetje e përgjigje jam ne dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rrethë kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Jakup Demiri: Këtu shërbime kontraktuese tjera, i keni prapë 54382 euro, kodi 13 460, prapë kodi 13 509 pajisjet tjera, që nuk janë të specifikuara. Kodi 13 620 furnizim me ushqim dhe pije, janë 43091 euro. Te mirëmbajtje

- riparimi i automjeteve, po më duhet shumë 12000 euro. Edhe shpenzime vendime të gjykatave janë 33500 euro. Këtë bile kisha kërkuar në seancë të kuvendit me pas një përshkrim të detajuar. Te faqe 15, te shpenzimet në shëndetësi, edhe këtu kod 13 620 furnizim me ushqim dhe pije 5441 dhe furnizim mjekësorë, është kod 13 630 38 mijë euro edhe te Drejtoria e Arsimit janë shërbime kontraktuese tjera, janë 11665 euro. Kodi 13640 furnizim pastrimi janë 9511 euro edhe sa është përqindja e ramjes desha me dit sa është.

z.Ibrahim Rama: Përqindja e inkasimit është 60.19%, krahasim me vitin e kaluar kemi ramje për 56%.

z.Bekim Azizi: Drejtor, nëse ka mundësi shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit **8550 euro**, kod 13 140. Te shërbimet kontraktuese tjera, unë po e shoh se është ma e madhe se e vitit të kaluar, kur e dimë se qe një kohë jemi duke punuar me staf të reduktuar. Te shërbimet e ndryshme shëndetësore, është ndryshimi shumë i madh 70%, diku se vitin e kaluar ndoshta ka qenë edhe e arsyeshme, këtë vit besoj që na i shpjegon. Diçka që më ka ra në sy drejtor, furnizim me ushqim dhe pije, kod 13 620. Ky kod na e dimë se viteve tjera ka qenë ma shumë për çerdhe, por e shoh se me krahasuar prej vitit të kaluar prej 11 mijë eurove, këtë vit është 43 mijë euro. D.m.th. është një ndryshim i madhe. Çfarë furnizimi ka pas këtë vit, furnizimi i pastrimit, na e dimë që vitin e kaluar 1700, ndërsa këtë vit është 30 mijë euro, çka ka me të apo kanë hyrë dezinfektimet në këtë kohë që janë bërë.

z.Ekrem Abazi: Gati po i bien me i përsëritë. I pata nënvizuar edhe unë disa pyetje me i bërë, por i thanë parafolësit e mi. Te të hyrat vetanake 28,90%, po besoj që është pak, po shumica prej këtyre të hyrave janë prej tatimit në pronë. Investimet kapitale 43%, edhe këtu ka mund me u bë ma shumë, unë jam kanë idhetar që me u nda me etapa, se këto kur vinë në fund vit prapë bëhen 99%, por unë prapë mendoj se duhet me u shpenzuar me etapa. Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, d.m.th. këtë vit shpenzimet janë ma të mëdha se vitin e kaluar. Telefonja fikse 4815 euro, kur ta marrësh si shumë, nuk është shumë, por kur e shikon se na krejt jena në rrjetë, prapë kur e ndajmë me mujore, 850 euro. Unë mendoj se është shumë, riparimi i automjeteve po e arsyetoj se për shkak të pandemisë ka pas lëvizje ma shumë. Shpenzime të gjykatave 33 mijë euro. Unë desha me ditë, shumë herë e kam thanë po e them prapë, trotuare e ndriçim janë dhanë 17 mijë euro edhe për ndriçim 55 mijë euro, bile me cek në cilin fshat a janë bërë kaq. Hartimi i projekteve 44 mijë euro, tu pas ingjiniera në komunë, teste për beton 12800 euro. Çka ki nevojë bre me dhanë atë shumë, veç merre një ternakop, meshoj pak edhe e dinë qa është, jo me dhënë gjithë atë shumë. Kaq kisha.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush tjetër. Pasi që nuk ka të tjerë për të diskutuar, u parashtua një numër i madh i pyetjeve, po ta kaloj fjalën drejtor.

z.Ibrahim Rama: Një pyetje ishte, shpenzimet për vendime gjyqësore 33524 euro, komplet kjo ka të bëjë me pagesa jubilarë dhe pensionimit të punëtorëve arsimor. Një pyetje tjetër e tatimit në pronë. Na e kemi dhanë me kontratë, kemi nënshkruar marrëveshje me posten me i shpërnda për vitin 2020 faktuarat e tatimit në pronë, po për shkak të situatës për këtë vit, nuk ka sanksione për vonesat e pagesës për shkak të pandemisë. Një pyetje tjetër e përbashkët, ke kod 13460 shërbime kontraktuese tjera 54 382 euro. Mbi 50 mijë euro shkon shuma për punëtorët që punojnë me kontrata me shërbime te veçanta, pagesë të komisione është 592 euro dhe asgjësimi i mbeturinave në shëndetësi 3666 euro në këtë, 13 509 shuma e kodit në shumë prej 17775 euro përfshinë mirëmbajtja e ndriçimit publik 10 mijë euro dhe instalimi i rrjetit të internetit të komunës 2359 euro edhe 4 mijë euro furnizimet për të gjitha drejtoritë. Kodi 13 620, shuma prej 43 mijë eurove përfshinë, këtu kanë të bëjnë me pjesën e vendimit që kanë të bëjnë me pandeminë d.m.th. vendimi që është nda prej 100 mijë euro për me plotësuar atë shumën ka qenë i shpërndarë sipas drejtorive. Furnizim me ushqim dhe pije të ndryshme, shëndetësia 441 euro, kjo është kod 13 620. Kodi 13 630, shuma është furnizim për barna dhe reagenca në shëndetësi, shuma është 38016 euro. Kodi 13 640, shuma është 29868 euro, në këtë shumë përfshihet furnizimi i pastrimit dezinfektimi dhe menaxhimi i emergjencës për cv19, shuma është 24451 euro dhe 4 mijë euro është furnizimi dhe pastrimi, d.m.th. shuma krejt është 29868 euro. Për shërbimet kontraktuese, do të ju a sjelli për kuvend një raport si specifikacion, edhe udhëtimet jashtë vendit shuma 8553 euro, këto janë shpenzime jo që ka bërë kryetari po ka të bëjë me projektin e Krosborderit, këto udhëtimet s'kanë ndodhë në këtë vit, por kemi paguar obligim për vitin që lamë pas.

Kryesuesi z.Naim Pira: Drejtori na i shpjegoj këto, por atë që e ceki Ekremi është mirë këshilltareve komunal me ja shpërndare, që mos me krijuar dilema të tilla.

z.Belçim Azizi: Ky projekt i Krosborderit, a ka përfunduar se na ke lodh. Ky është projekt 2 vjeçar, me na i shpjeguar.

z. Ibrahim Rama: Këtu janë dy projekte, projekti i fundit i kros borderit i bashkimit evropian ka filluar në vitin 2018 ka përfunduar në vitin 2019, por një pjesë e fondit prej 20 mijë euro nuk na i kanë qit vitin e kaluar, i kanë qit këtë vit edhe na këtë vit e kemi shpenzuar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Drejtor, unë po të falënderoj që i ke sjell pasqyrat financiare. Për pyetjet që mbeten të pasqaruara dhe u morr përgjegjësi për me i sjell në kuvend, të kisha lut që të i sjellësh.

Si pikë të tretë kemi

3. Propozim vendim për shpalljen në diskutim publik propozim rregulloren për taksa , ngarkesa dhe gjoba për vitin 2021

Janë dy rregullore përpara, kemi arrit mi miratuar në fund të vitit, por tash me sugjerimin e ministrisë këto duhet me u miratuar me miratim të buxhetit, kështu që i kemi sjellur tash se ju nënshtrohen edhe dëgjimit publik me qytetar, sa më kanë informuar drejtorët nuk ka ndryshime, mirëpo janë procedura që duhet me kaluar përmes kuvendit. Ja kisha kaluar fjalën drejtorit rreth kësaj pike.

z.Ibrahim Rama: Neve na ka ardhur njoftimi i ministrisë, se rregullorja duhet me u miratuar me buxhet bashkë ne do ti ndjekim procedurat që ta qesim edhe në dëgjim publik dhe do të sjellët si e kompletuar në kuvend pas dëgjimit si e kompletuar për miratim.

Kryesuesi z.Naim Pira: Kush është që të shkoj ma tutje ky propozim. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. Propozim vendim për shpalljen në diskutim publik propozimin e rregullores për ndryshimin e rregullores për Tatimin në Pronë të Komunës së Vitisë për vitin 2021

Edhe kjo shkon për dëgjim publik. Kush është që të shkoj për kuvend kjo pikë? Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pike të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e proceduarave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim

Ja kisha kaluar fjalën nënkryetarit.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Para jush e keni një propozim vendim, është fjala për tregun e kafshëve të cilin e kemi përgatitur, po dojmë mos me lan në mëshirë ashtu si ka qenë “Eko hixhiena”, kështu që me qit në ankand me ja dhanë dikujt që është ma profesional edhe që afron shërbim ma të mirë, atyre që e frekuentojnë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Ekrem Abazi: Komuna a përfiton diçka prek kësaj. Unë mendoj sa do pak me përfituar vetëm atë vend me mbajta mirë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Nëse nuk ka dikush tjetër për të diskutuar: kush është që të shkoj në kuvend kjo pikë? Konstatoj se edhe kjo pikë shkon në kuvend për miratim.

Si pikë të gjatë të rendit të ditës kemi

6. Propozim vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik

Edhe për këtë ja kisha kaluar fjalën nënkryetarit.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: E para ishte propozim vendim për formimin e komisionit. Këtu e kanë propozuar se në atë kohë kemi pasur përfaqësues nga ekzekutivi, është një prej inspeksionit ndersa prej kadastrri është propozuar Xhelal Shaqiri dhe masandej unë besoj se në kuvend i propozoni 3 përfaqësues të kuvendit edhe një nga sektori jo qeveritar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka për diskutim, kush është që të shkoj për miratim në kuvend edhe kjo

pikë të rendit të ditës. Konstatohet se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pike të tetë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e ambulantes shëndetësore në fshatin Tërpezë, të datës 07.05.2020, me Nr.02-035/02-366

E diskutuam edhe ma herët këtë pikë. Kush është që të shfuqizohet kjo pike? Konstatohet që shkon në kuvend për shfuqizim.

Si pike të tetë të rendit të ditës kemi:

8. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e Vendimit Nr.01-110/05-370, të datës 08.05.2020, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e ambulancës shëndetësore në Tërpezë

Ja kisha kaluar fjalën nënkryetarit.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Unë momentin kur e kam marr shkresën nga ana e juaj, kam thirr edhe Zyrën Ligjore edhe drejtoritë përkatëse, dhe ata e kanë sjellë këtë propozim vendim në kuadër të konturave dhe sugjerimeve të cilat i ka dhanë ministria. Tash të shohim.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike ju lutëm.

z.Bekim Azizi: Anulimi i këtij vendimi që bëhet, është për shkak se është ndarë të ndërtohet në oborr të shkollës, se ka pas reagime edhe nga fshataret atje, që mos me u ndërtuar në oborr të shkollës. Nëse e qojmë prapë aty, prapë kemi me pas telashe. Nuk jam për me u ndërtuar në oborr të shkollës përderisa është anuluar me vendim të ministrisë, që mos të jetë ambulanta aty, sepse ka tjera hapësira ku mundet me u ndërtuar.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Ministria vërejtjen e ka dhanë te pjesa hyrëse, sepse ka thanë që nuk jeni thirrur në planin hapësinor dhe në planin zhvillimor të komunës, që besoj se tash i kemi harmonizuar. Sa i përket vendit, na i kemi lanë një tri javë me vendos, dhe në fund kur ka ardhur çështja, këta janë kanë me këtë propozim. Mundet me pas edhe mendime të kundërta, por mendimi i shumicës ka qenë për këtë vend.

z.Basri Aliu: Unë realisht jam merr me këtë çështje dhe me këshillin e fshatit. Ata kanë vendosur që të shkolla me u ndërtuar, ka pas edhe mendime të ndryshme, por sipas mendimit tim, nga ana funksionale, që duhet me qenë realisht ambullanta duhet me qenë ka qendra e fshatit, në mënyrë që qytetaret të jenë ma afër kësaj. Nëse e dërgojmë atje ku po mendojnë disa, atëherë kur t'i hypë veturës, nuk ndalet aty hiq, po shkon drejt në Pozheran. Është fakt që e ngushton pak oborrrin e shkollës, por ambulantë mundet me qenë edhe brenda shkollës. Kemi shikuar edhe pjesë përball varrezave të vjetra, por vendi ma i mirë është aty ku e kemi caktuar.

z.Jakup Demiri: Mua po më duket që është e njëjtë. Unë nuk jam që mos me u ndërtuar, vetëm të kemi kujdes, se mundet me qenë prapë e jashtëligjshme.

z.Ekrem Abazi: Unë qysh munda me kuptuar, shumica qenkan që aty me u ndërtuar ambulanta, por unë kisha kërkuar, se hymja e ambulantes mos me qenë me të njëjtën hyrje të shkollës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Atëherë: kush është që të shkoj për kuvend? Faleminderit, shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të nëntë të rendit të ditës kemi:

9. Propozim vendim për caktimin e komisionit për intervistimin, vlerësimin, poentimin e kandidateve të cilët janë konkurruar në konkurset publike për pozitat, drejtor, zv. drejtor të shkollave fillore - mesme dhe çerdhesh së fëmijëve të Komunës së Vitisë

Ja kisha dhanë fjalën drejtorit të arsimit, rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Basri Aliu: Sipas udhëzimit administrativ 6, të vitit 2019, është cek, se komisioni intervistues duhet të zgjidhet përmes kuvendit.

Kryesuesi z. Naim Pira: Vetëm një shpjegim. Kuvendi ja voton komisionin që e propozon DKA-ja. Unë e kam lexuar udhëzimin administrativ, kur është fjala te kandidatet kur konkurrojnë për pozita të tilla dhe anëtarët e komisionit duhet të janë të barasvlershëm me përgatitjen e tyre profesionale me kandidatet. Po themë, këta kandida që janë këtu, a mund me na i kontestuar dikush.

z.Jakup Demiri: Unë jam pikërisht për këtë. pika 1.3 thotë: "që anetarët nuk mund të jenë të emëruar politik, edhe Izjadin Ahmeti edhe Avdyli Misini e di që këta dytë janë politikë. Sa i përket punësimit, na krejt e kemi ditë që Izjadin shkoi në atë pozitë. Unë mendoj se nuk ja vien me qenë Izjadin edhe Avdyli, se Izjadin është veç e Sokolli. Unë jam kaftas për dy njerëz që i njoh, mirë unë po ftas për një komision, unë e kam obligim, pasi që jam këtu me thanë të vërtetën dhe me dhanë kontributin tim.

Kryesuesi z.Naim Pira: Në bazë të udhëzimit administrativ shkoi Avdyli, se është kryetar i Këshillit të Prindërve, ndërsa Izjadin është zyrtar komunal.

z.Basri Aliu: Të emëruar politikisht mundem me qenë unë, a shërbyesit civil nuk mundesh mi thanë të që është politik. Unë po të them, se këto janë paragjykime të tuat. Kryesues, sa i përket sa kredi i kanë, a duhet deri në 240 kredi, po tash komisioni nuk po e di sa i kanë ato kredi, por kryetari i Këshillit të Prindërve, a do të mund të ketë këto kredi?

Kryesuesi z.Naim Pira: Ky është komisioni, veç ministria varet kanë e dërgon, tash është dilema a duhet veç njëri me qenë i barasvlershëm me kredit e tyre, a duhet me qenë të tretë, unë nuk e di.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Vetëm ta kemi të qartë Jakup, krejt shkollat i kanë këshillat e prindërve, Vitia nuk ka pasur mandatin e parë, nuk ka pasur kryetar të këshillave të prindërve, dhe unë kam pas dilemë, kam thanë, prej tri shkollave Pozherani, gjimnazi edhe teknika, vetëm le të ma dërgojnë për me hy në KKSB, neve na ka ardhur me shkrim se kryetar i Këshillave të Prindërve në krejt shkollat është Avdyli Misini.

z.Ekrem Abazi: Vetëm qetu që po thotë, me mundësi të plotësimit të komisionit nga kuvendi komunal, te pika 4, edhe po befasona me Jakupin që po bisedon për kësi imtësi, p.sh e përmendi Sokolin, kryetarin i ka zgjedh njerëzit e LDK-së për dhënien e bursave, ai s'ka guxuar as veshin me luajtur, veç qysh i kanë thanë.

z.Bekim Azizi: Kjo është e re që na vjen në kuvend, për herë të parë na me ba një komision edhe mos me qenë asnjë prej kuvendi, po me duket palidhje çka ka nevojë me ardh te na. E dyta, çështja e komisionit. Parimisht i njohim e dimë që e kryen punën, tamam e dimë edhe kush vjen drejtor, nëse doni edhe emrat ja u japi. Çështja tjetër, sa i përket kredive, Izjadin e ka shkollën e lartë të matematikës, Avdyli e ka fakultetin e gjuhës shqipe, ai del pension edhe 5 apo 6 muaj, qysh janë zgjedhë këshillat e prindërve të shkollës, ma mirë mos me ditë hiq.

Kryesuesi z.Naim Pira: Jam kanë i interesuar me shikuar këtë çështje, për shkak se me i krye procedurat Drejtoria e Arsimit, krejt komunat kanë pasur vërejtje në këtë aspekt.

z.Basri Aliu: A vjen kush vjen unë nuk e di, po mundet me të dështuar konkursi për shkak mos konkurrimit.

Kryesuesi z.Naim Pira: Kush është që ti rekomandohet kuvendit kjo pikë e rendit të ditës? Faleminderit, edhe kjo pikë shkon për kuvend.

Si pikë të dhjetë te rendit të ditës kemi:

10. Propozim vendim për miratimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Urdhëro drejtor i Shërbimeve publike.

z.Nexhmedin Jakupi: Bëhet fjalë për një dokument mjaft të rëndësishëm, ne e kemi pas në dëgjim publik dhe ne e kemi sjell si draft final për miratim. Për ma shumë nuk kisha diçka, nëse keni ndonjë sqarim jam në dispozicion të ju ndihmoj.

Kryesuesi z. Naim Pira: Hapim debat rrethë kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm

z.Bekim Azizi: Unë nuk pash që është bërë ndonjë përmirësim, është e njëjta prej debatit që na ka ardh si herë e kaluar. Unë për vete një pjesë janë ma të ngarkuar se sa kanë qenë na thjesht jena duke ja bërë një argat "Ek Hixhienes". Nëse hyp menaxhimi i mbeturinave, se ke qare pa e hyp edhe ti këtu çmimin, mirëpo duhet me ngr çmimin. Qato që i bëjnë mbeturinat e ke një shembull, orari ai 7 kg qe 20 vite nuk i ka bërë mbeturina, e ka 7 eur në muaj, ke edhe shumë biznese tjera që i ke të ngarkuara pa nevojë. Te ekonomitë familjare ka shkuar njëjtë. Unë mendoj se kjo pjesa e njerëzve që nuk jetojnë këtu, është bërë mirë te pjesa tjetër, është jashtëzakonisht jo në rregull dhe unë nuk mundem me votuar pro kësaj, bizneset nuk mund me qenë njëjtë si një vullkanizer, si një ortar si një zyre këshillëdhënëse, d.m.th janë diferenca shumë të mëdha, që për mendimin tim janë keq dhe tash kur ti krahaso këto i ke 250 mijë euro, ka hyrje që është një hyrje e madhe për vitin 2019. Në amvisni i ka të garantuara 194 mij

euro, 97% i ka inkasuar të hërrat. Vëc analizone, këto se prej diku 8 mijë familje vëc 3500 janë në sistem të mbeturinave, i ke vetëm rrugët kryesore, as nuk bëhet menaxhimi i mirë i mbeturinave. Ata që s'janë në menaxhim të mbeturinave, se kanë qare pa i hedhë mbeturinat neper vende ku ka ndonjë gropë dhe kjo është një dukuri që ka me na përejellë që nuk i kemi paraparë mirë. Unë mendoj që nuk është bërë një ngarkesë e mirë, unë mendoj se me këto kemi me ju hy në hak, jemi duke i bere sherbim vetem "Eko Hixhienes", do të kërkoj edhe në kuvend mos me u votuar me këto tarifa.

z.Ekrem Abazi: Unë për caktimin e tarifës A1 A2, unë jam kundër dhe mendoj që prej 7 euro me shkua në 5 euro k2 me shkua prej 11.7 në 7 euro K3 nga 20.7 euro në 13 euro edhe k4 nga 27.8 me shkua 16 euro VIVA, ETC, INTEREX, MEDITERAN ngarkohen nga 40 euro te gjobot mu duk që e keni bërë si këta kush e then ligjin për pandemi 2 vjet deri në 12 vjet burg gjobot aty ku është 20 euro me i zvogëluar përgjysmë mi ba 10 euro për səcile.

z.Nexhmedin Jakupi: Duhet me pas parasysh, se Ministra për Zhvillim Ekonomik, e cila e bënë vlerësimin e taksës që paguan tash kompanitë për me dërgua në deponoi e paguajnë një taksë shumë ma të madhe se sa e kanë pasur.

z.Bekim Azizi: Qasja e drejtorit është e gabuar, për gjoba nuk diskutova, se është çështja e ligjit, ti këtu e ke planin, gjema një vend që e keni gjetur që me i hedhë mbeturinat e ngurta, ja ku e ke planin. Unë po them që është një pjesë e bizneseve që nuk kanë hiq mbeturina dhe na i ngarkojmë njëjtë.

z.Nexhmedin Jakupi: Unë dua ta tregoj një rast Bekim, një avokat çdo mëngjes nga një qese me letra e hedh në këto shportat e qytetit që i kemi vendosur dhe këto shporta nuk i shprazë "Eko Hixhiena" po i shprazim ne me këtë projektin që e kemi. Vetëm edhe një sqarim, kjo ka të bëjë vetëm me mbeturinat komunale, këto tarifa komunale.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që kuvendi e ka të drejtën ekskluzive për këtë çështje, për me qenë në nivel të detyrës edhe këshilltaret e kuvendit komunal, por nëse na e krahasojmë një shitore apo një gjellëtoe me VIVEN ose ETC, që këto me tonelata bëjnë bërlllok edhe kjo është e pandershme. Unë po them, duhet me bë një kategorizim përafërsisht ashtu si i ka hije.

z.Bekim Azizi: Edhe një shembull po e marr, ka një fitnes çfarë mbeturina ka një biznes ku e keni qit 20.7 euro. Tash nëse hymë mi kategorizuar bizneset, kemi punë shumë, nëse nuk e banë asnjë deponoi apo nëse nuk shpenzon rrymë edhe të vjen faktuara e rrymës, është e vështir edhe me paguar, se dikujt i vjen faktuara qe 20 vite dhe ai s'ka hedh asnjë herë bërlllok. Unë jam duke e diskutuar ku ka shumë mbeturina edhe me rritë taksen.

Kryesuesi z. Naim Pira: Atëherë, nëse nuk ka diçka ma shumë, e qesim në votim që të shkoj për miratim në kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vetëm kisha kërkuar, që edhe anëtarët e grupes punuese le të vinë në kuvend dhe të harmonizojmë, sepse është një rregullore që ka implikime madhore dhe ja sheh sherrin dikush. Shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të dhjetë të rendit të ditës kemi:

11.Propozim vendim për miratimin e draft planit komunal për menaxhimin e mbeturinave të komunës së Vitisë, 2020-2025

Pasi e diskutuam edhe për këtë pike, kush është që të shkoj për kuvend edhe kjo pike e rendit të ditës. Konstatohet se shkon për kuvend edhe kjo pikë.

Si pike të dymbëdhjetë të rendit të ditës kemi:

12.Propozim vendim Plani Komunal i veprimit për Eficencë të Enërgjisë (PKVEE) 2019-2021

Pasi që përfaqësuesi nuk qenka, na e kemi pas edhe më pare, i ka ndjek edhe procedurat e dëgjimit publik. A ka dikush me diskutuar rreth kësaj pike të rendit të ditës? Nëse nuk ka, unë po e qes në votim që të shkoj për miratim në kuvend. Konstatohet se shkon për kuvend edhe kjo pike e rendit të ditës.

S' pike tjetër të rendit të ditës kemi:

13. Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2019-2020 nga DKA- Viti

Po ja kaloj fjalën drejtorit rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Basri Aliu: Viti shkollor ka filluar me kohë gjysmëvjetori i parë gjithashtu ka përfunduar sipas ligjeve në fuqi, ndërsa në gjysmëvjetorin e dytë, pas atij problemi që dihet për shkak të pandemisë, mësimi iu ndërpre me 11 mars sipas vendimit të Ministrisë së Arsimit, deri me 23 mars kur Ministria Arsimit ka vendosur që mësimi të mbahet onlin, përmes RTK-së kanë dhanë ligjërata. Gjatë kësaj periudhe i kanë sjell disa udhëzime Ministria e Arsimit, që është dashtë të zbatohen. Përfundimi i vitit shkollor është bërë sipas udhëzimeve që i ka dhanë MASHT-i, vështirësitë kanë qenë sidomos të disa nxënës që nuk kanë pasur qasje në internet, por me rëndësi është, që diku 95% kanë pasur qasje. Unë s'kisha me zgjat ma shumë, nëse keni ndonjë pyetje apo ndonjë sqarim, jam këtu për të ju ndihmuar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: a donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

z.Bekim Azizi: Unë po mendoj se ky me qenë raport shkollor është gjynah, këtu vetëm ja kanë ndërruar datën, i njëjti që na i sjellke Qahili është. Informata për përfundimin e vitit shkollor, e paraqet prej shtatorit e deri në fund të vitit, paraqitet informata vetëm një, po të them këtu kur thotë sa ka qenë i suksesshëm, apo me ngecje, jemi të vetëdijshëm, që ndoshta nuk janë arritur objektivat 100%, por afër 90%. Na këto objektiva as në kushtet normale nuk jemi duke mund me i arritur, s'kemi asnjë informatë sa nxënës kanë filluar, sa kanë mbërri deri në fund, sa kemi pasur nëpër transfere, i ka rrok pandemia, edhe qysh ka qenë gjendja tyre. Tash që kemi ardhur në fund, as sa është numri i mungesave, shumë faktor janë që u dashtë me u përmend në raport. Neve na ka ardhur vendimi me 22 maj, që mësimi përfundon me 20 maj. Na e dimë qysh ka shkuar përfundimi, por pasi që është edhe raporti i kryetarit, ishalla keni përfshi ma shumë aty informata.

z.Basri Aliu: Vetëm një sqarim. Kjo është informatë për përfundimin e viti shkollor, ndërsa raportin e keni edhe atë, por që është i përfshirë në raportin e kryetarit që do ta keni si pikë në kuvend, për ata desha vetëm të bëhet dallimi, se na këtu kemi sjellë një informatë rreth përfundimit të vitit shkollor. Unë e thash edhe ma herët, se kjo ka qenë informatë e shkurtër për përfundimin e vitit shkollor. Sa i përket qasjes së mësimi, të kyqjës së mësimi onlin, me siguri e din edhe ti, se edhe ti ke raportuar te drejtori, sa kanë qenë nxënës që kanë marruar pjesë. Unë këtë përqindje e kam prej mësimdhësave, që kanë raportuar te drejtori dhe drejtorët i kanë sjell te na. Numri i mospjesëmarrjes, na e kemi, por nuk mu ka duk i arsyeshëm me qit këtu. Realisht mësimi për shkollat e mesme në viti, ka përfunduar me datë 22.06.2020.

z.Bekim Azizi: Në bazë të raportit që e ke ti, 93% janë nxënës që kanë pasur qasje në sistemin online. Notimi është 100%. Tash në bazë të saj ky 7 % shi që s'ka qenë i kyqur, si keni vepruar?

z.Basri Aliu: Sipas udhëzimeve që i kemi, ata nxënës që nuk e ndjekin, aty është përgjegjësi e drejtorëve dhe e mësimdhënësve, se ata kanë pas drejtë me vendos për ata nxënës, se nëse tri periodat e para notën e ka pasur të përcaktuar, po e marr shembull shumë mirë, nuk ke mund me notuar me not ma të ulët. Për ata që nuk kanë qenë të kyqur, ka qenë obligim i mësimdhënësit me u marr me atë nxënës, me punuar, e sa e kanë aplikuar disa mësimdhënës, kjo është çështje tjetër.

Kryesuesi z.Naim Pira: Drejtor, faleminderit që na i ke sjellur informatën. Unë kam edhe diçka, ka qenë edhe një propozim për diskutim publik për planin e punës së Kuvendit të Vitisë, apo dakordohemi që për kuvend të sjellim që ta merr vizën të del në dëgjim publik? Dhe tjetra, që po dua me ju thanë, të enjten është Natë Bajrami desha me ju lutë, kështu, miqësisht, a ka mundësi unë sot me caktuar seancën për të mërkurën? Faleminderit shumë!

Mekaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.


Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Procedambajtësi:
Fatlun Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA Kosovo			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Prilazje Mirëdita 15-09-2022			
Nr. i organit Org. broj	Numri/ Broj	Shprehje Prilog	Vlera Vrednos*
02-035/02 884			



Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011 , Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

PROPOZIM VENDIM
PËR PROJEKT BUXHETIN E KOMUNËS SË VITISË 2021-2023

Neni 1

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin e „ PROJEKT BUXHETI I KOMUNËS SË VITISË 2021-2023 “

Duke u bazuar në QARKOREN BUXHETORE 2021/02 të datës 11.08.2020 të lëshuar nga MF-ja me nr 01/1163 nga ministria e Financave ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2021-2023.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është „ PROJEKT BUXHETIN E KOMUNËS SË VITISË 2021-2023 “ e hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim .

Neni 3


Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

PROPOZUES : KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti





KOMUNA E VITISË

PLAN BUXHETI 2021 - 2023

Drejtori i drejtoris për FEZH

Ibrahim Rama

Shtator 2020

Kryetari i Komunës

Sokol Haliti



PLAN BUXHETI 2021-2023

Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm i politikës ekonomike që ka në dispozicion qeveria komunale, dhe si i tillë ai pasqyron prioritetet e saja zhvillimore. Derisa buxheti rregullon të hyrat dhe shpenzimet për një vit fiskal të caktuar, procesi buxhetor është i vazhdueshëm dhe përsëritet çdo vit. Edhe pse në kushte të renda pune- pandemie komuna ka hartuar edhe Kornizën Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve (KAB-i), një dokument planifikues afatmesëm që synon të përmirësojë parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e buxhetit, duke përfshirë buxhetin e vitit të ardhshëm fiskal dhe parashikimet buxhetore edhe për dy vitet fiskale të tjera. Kur përpilohet buxheti vjetor, Ministria e Financave i nxjerr qarkoret buxhetore 1 dhe 2 etj, që japin kufijt fillestar, informata dhe udhëzime rreth strukture së shpenzimeve në fonde burimore dhe kategori ekonomike për vitin e ardhshëm fiskal dhe parashikimet për dy vitete pasuese, përcaktojnë procesin e bashkërendimit midis organizatave buxhetore dhe Ministrisë së Financave. Në bazë të këtyre propozim-buxheteve, Ministri i Financave përgatitë Propozim-buxhetin e Kosovës dhe Projektligjin për ndarjet buxhetore dhe ia dorëzon ato për shqyrtim qeverisë. Qeveria duhet ta paraqesë projektligjin për shqyrtim në Kuvend deri më 31 tetor të vitit aktual fiskal.

Organizatave buxhetore të nivelit lokal - Komunat duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:

- **30 Qershor: Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale,**
- **30 Shtator: Aprovimi i propozim Buxhetit Komunal për vitin 2021-2023 nga Kuvendi Komunal,**
 - **30 Shtator: pas aprovimit të propozim Buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave dokumentet si në vijim:**
 - Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
 - Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2021-2023, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
 - Tabelat e buxhetit komunal (SZHMB-se dhe PIP):
 - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2021-2023 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2021 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2022 dhe 2023 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga SZHMB-se, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjzinor.

Përgatitja e buxhetit 2021-2023 ka filluar nga muaji maj i vitit 2020, konform LMFPF dhe Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal. Këtë periudhë kohore e kanë përcjellë dy qarkore buxhetore të lëshuara nga MF-ja, qarkorja e parë buxhetore 2021/01, të datës 15.05.2020 dhe qarkorja e dytë buxhetore 2021/02 të datës 11.08.2020 të lëshuar nga MF-ja, dhe qarkorja e tretë 2021/03 e datës 14.09.2020.

Me qarkoren buxhetore 2020/02 jemi njoftuar për strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2021 si dhe parashikimet për vitin 2022 dhe 2023.

Kufijt nëpër kategori ekonomike janë të përcaktuar me qarkoren buxhetore 2020/02 kështu:

Paraqitja e buxhetit sipas kategorive ekonomike

Paraqitja e buxhetit për vitin 2021 sipas kategorive ekonomike			
nr.	Kategorit ekonomike	Shuma	%
1	Pagat dhe shtesat	7.437.105	59,54
2	Mallrat dhe Shërbime	1.918.949	15,36
3	Shpenzime Komunale	320.000	2,56
4	Subvencione, transfere	350.000	2,80
5	Shpenzimet Kapitale	2.464.632	19,73
	TOTALI	12.490,686	100,00

Shuma e grantit qeveritar është 11,629,436 €, të hyrat vetanake 861,250 € totali buxhetor 12,490,686 €.

Plan buxheti i vitit 2021 është përgatitur në bazë të Statutit të Komunës së Vitisë, duke bërë shpërndarjen e fondeve nëpër drejtori / programe dhe nënprograme.

Në qarkoren e parë buxhetore 2021/01 paraqiten udhëzimet e para: kalendari kohor, kufijt fillestar të përgatitjes së KAB-it Komunal dhe fillimit të përgatitjes së Draft (projekt) Buxhetit Komunal për vitet 2021-2023. Në qarkoren e dytë buxhetore 2021/02 janë dhënë kufijt e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike (duke përfshirë shpenzimet e pagave dhe shtesave, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale) për vitet 2021-2023, por edhe me qarkoren e tretë buxhetore 2021/03 janë dhënë kufijt definitiv të buxhetit sipas kategorive ekonomike .

Buxheti komunal për vitin fiskal 2021-2023 do të paraqitet sipas 5 kategorive ekonomike për shpenzimet e buxhetuara në pajtim me rregullat e thesarit:

1. Paga e shtesa,
2. Mallëra dhe shërbime,
3. Shpenzime komunale,
4. Subvencione e transfere, si dhe
5. Shpenzime kapitale

KUFIJT BUXHETOR SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE PËR VITET 2020-2023				
Kategorit ekonomike	Viti 2019	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Pagat dhe shtesat	8.484.678	7,437,105	7,457,631	7,494,920
Mallra e shërbime	1.631.703	1,918,949	2,003,382	1,966,386
Shpenzime komunale	279.000	320,000	325,031	338,574
Subven. e transfere	250.000	350,000	372,980	394,920
Shpenzime kapitale	1.660.150	2,464,632	3,881,723	4,187,444
Totali	12.305.491	12,490,686	14,040,747	14,382,244

Ndryshimi i kufijëve buxhetor për vitin 2020 në krahasim me vitin 2019

✓	Granti i Përgjithshëm	(zbritje 373,333)		4.575,868
✓	Granti i Arsimit	(rritje 569,197)		5.425,184
✓	Granti i shëndetësisë	(rritje 46,680)		1.628,384
✓	Të hyrat vetanake	(zbritje 87,349)		861,250
Gjithësejt.....		(rritje 470,704)		12.490,686

Dallimi i buxhetit në mes të viteve 2020 dhe 2021


nr.	Kategorit ekonomike	2020	2021	diferenca
1	Paga e mëditje	7.387.753	7.437.105	49.352
2	Mallra e shërbime	1.631.703	1.918.949	287.246
3	Shpenzime komunale	279.000	320.000	41.000
4	Subven. e transfere	250.000	350.000	100.000
5	Shpenzime kapitale	1.660.150	2.464.632	804.482
	Totali	11.208.606	12.490.686	1.282.080
	Rezerva	1,096,885		
	Totali	12.305.491		

Buxheti i Komunës së Vitisë përbëhet nga dy burime kryesore.

1. **Grantet qeveritare** (granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit dhe granti specifik i shëndetësisë),
2. **Të hyrat vetanake komunale.**

Buxheti i Komunës në vitet 2019 – 2023

Buxheti sipas viteve	
Viti 2019	11.399.551,00
Viti 2020	12.305.491,00
Viti 2021	12.490.686,00
Viti 2022	14.040.747,00
Viti 2023	14.382.244,00



Buxheti i Komunës së Vitisë si tërësi ka shënuar rritje në vitin 2021 prej 185,195 € ose prej 1.5 %. Në vitin 2020 shuma e buxhetit është prej 12,305,490 €, në vitin 2021 shuma e buxhetit është prej 12,490,686 €, në vitin 2022 shuma prej 14,040,749 € në vitin 2023 është prej 14,382,244.€.

Viti 2021 në krahasim me vitin 2020 ka rritje prej 1.50 %, viti 2022 në krahasim me vitin 2021 ka rritje prej 12.41% dhe viti 2023 në krahasim me vitin 2021 ka rritje prej 15.14 %.

Rritje është reflektuar në Grantin e Arsimit prej 569,197 € dhe grantin e Shëndetësisë në vlerë prej 46,680 €, dhe zbritje në grantin e përgjithshëm prej 343,333 €, kurse total grantet kanë rritje prej 185,195 €.

Të hyrat vetanake komunale kanë zbritje në krahasim me vitin 2020 prej në shumë prej 87,349 (948,599 – 861,250) €.

Në materialin e paraqitur kemi planifikimin e buxhetit për të gjitha linjat buxhetore, si: administrata komunale, arsimi, shëndetësia dhe mirëqenja sociale dhe shërbimet sociale. Këtu janë përdorur të gjitha kriteret të cilat janë të parapara me LMFP, për ndarjen e buxhetit, kriteri funksional, organizativ, ekonomik e burimor, duke e respektuar edhe kodin e nënzërave pesë shifror i domosdoshëm për të zbraz të dhënat në sistemin e BDMS-së.

Ndarja e mjeteve të **grantit të përgjithshëm** duke kalkuluar në nr e popullsis sipas regjistrimit të popullsis të vitit 2011 komua jonë ka numër të banorëve prej 46,987 banor ,bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (I) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (II) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (III) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (IV) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%). (Shif QB2021/02 faqe 10)

Në kuadër të programit të arsimit kemi ndarjen sipas katër nënprogrameve në:

1. Administratë (financohet nga granti i përgjithshëm),,
2. Arsimi parashkollor / çerdhet,
3. Arsimi fillor,
4. Arsimi i mesëm.

Në programin e **arsimit** aplikohet sistemi i hapur i financimit duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHT-it për vitin 2021 buxhet për çdo shkollë, formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm duke marrë për bazë këto kriteret:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2019/2020;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.22/2013 të MASHT);
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
